

---

## Ftesë për Konsultim Publik


### Për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prizrenit


Të nderuar qytetarë,


Projekti “**EMPOWERED- Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara, Bashkëpunimi Rajonal dhe Zhvillimi në Ballkanin Perëndimor**” ju fton në një **Konsultim Publik** me temën **Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)** në komunën tonë. Ky aktivitet është pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të zhvilluar politika lokale gjithëpërfshirëse dhe projekte konkrete që adresojnë nevojat reale të PAK-ve dhe familjeve të tyre.

Gjatë periudhës së fundit janë organizuar disa takime me anëtarët e Grupit të Fokusit, ku përmes diskutimeve të strukturuar janë identifikuar prioritetet infrastrukurore, nevojat për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, si dhe janë formësuar ide konkrete që synojnë të integrohen në planet zhvillimore të ardhshme të komunës.

Në këtë kuadër, me qëllim prezantimin dhe diskutimin e projekteve konkrete që synojnë adresimin e prioriteteve, ftojmë qytetarët, prindërit dhe kujdestarët e PAK-ve, asistentët personalë, edukatorët, përfaqësuesit e institucioneve komunale, si dhe të gjithë të interesuarit, që të marrin pjesë aktive në këtë konsultim.

 **Data:** 16.04.2026

 **Ora:** 10:30-11:40

 **Vendi:** Komuna e Prizrenit

Kontributi dhe mendimet tuaja janë thelbësore për të siguruar që ndërhyrjet e planifikuara të jenë sa më gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat reale të komunitetit.

Me kënaqësi presim pjesëmarrjen tuaj!

Me respekt,

**PREDA Plus dhe Komuna e Prizrenit**

---

## Konsultim Publik

**Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në komunën e Prizrenit.**

**Data:** 16.04.2026

**Vendi:** Komuna Prizren (salla e asamblesë)

### Axhenda

Koha	Tema	Përgjegjës(i)
10:30 – 10:35	Hapja e takimit	Moderatori
10:35 - 10:45	<b>Prezentim i shkurtër i zhvillimit të Projektit</b> “Fuqizimi – Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara, Bashkëpunimi Rajonal dhe Zhvillimi në Ballkanin Perëndimor”	Koordinatori / PREDA Plus
10:45 - 10:55	<b>Përmbledhje e projekt ideve</b> nga takimi i Grupit të Fokusit Komunal	Koordinatori / PREDA Plus
10:55 – 11:35	<b>Diskutim i hapur</b> për prioritetet e synuara, kërkesa dhe ide për projekte	Moderatori Komuna Të gjithë pjesëmarrësit
11:35 - 11:40	<b>Përmbyllje</b> dhe hapat e radhës	Moderatori

---

Implemented by: